

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E HËNË 8 NËNTOR 2021

Faleminderit, Kryetare!

Në emër të Grupit Parlamentar, unë dua të shpreh mbështetjen e plotë për aktin normativ, mbështetjen e plotë ndaj qeverisë, e cila në këtë akt normativ, në mbështetje të qytetarëve, sjell dy ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2021. Së pari, akordimin e mbështetjes financiare për OSHEE-në nëpërmjet një instrumenti që është garancia. OSHEE-ja duhet t'i paguajë vetë detyrimet e saj, por qeveria del garant.

Së dyti, rritjen e kufirit të huamarrjes neto vjetore për të akomoduar daljen me eurobond në tregjet ndërkombëtare me vlerën 700 milionë euro, e kushtëzuar nga rritja e menjëhershme e çmimeve në tregun e parregulluar të energjisë elektrike. Ne, sigurisht, jemi të përgjegjshëm që situata e nevojës dhe emergjencës në vitin 2021, në këto kushte të rritjes së çmimit të energjisë, dikton nevojën edhe për rritjen e eurobondit nga 500 në 700 milionë, edhe për mbështetjen e OSHEE-së, sepse dikton nevojën për të mbështetur furnizimin e pandërprerë me energji elektrike për çdo qytetar, njëkohësisht, për financimin e të gjitha projekteve, ato që u përmendën më parë nga Kryeministri Rama dhe, mbi të gjitha, për të thelluar edhe më tej eficiencën e investimeve të buxhetit të qeverisë shqiptare. Kryeministri përmendi pak më parë se sa është eficienta e investimeve për 100 lekë borxh të marrë në qeverisjen tuaj dhe sa është për 100 lekë borxh në qeverisjen e PS-së, por nuk përmendi se sa ishte parashikimi në vitin 2021, që shkon në 250 lekë për 100 lekë të marrë borxh. Për të ardhur pak në ndihmë të debatit të vlerësimeve pozitive për emetimin e eurobondit, dua të përmend jo vetëm uljen e çmimit në gjysmë në 5 vjet, që nga emetimi në vitin 2015, por edhe dy elemente të tjera shumë të rëndësishme.

Së pari, se sa është rritur ai që quhet "raporti i mbulimit". Ne në daljen e fundit në vitin 2020 patëm 4 herë më shumë kërkesa se sa ajo që ofruam në shumën e 650 milionë eurove. Së dyti, për t'i dhënë një përgjigje kolegut të Komisionit të Ekonomisë, është e vërtetë që ne morëm me kupon 3,5, por Maqedonia e Veriut në datën 27 maj 2020 e ka marrë me 3,67; Rumania me 3,6, edhe pse shkoi për 2 milionë. Prandaj, meqenëse e kërkuat për referencë me rajonin, jemi më pak se të dyja shtetet dhe kjo është pikërisht për vlerësimin pozitiv që kanë ruajtur financat publike edhe në një vit të vështirë, si viti 2020, edhe pse me dy goditje, si pandemia dhe tërmeti. Së fundi, në raport me menaxhimin efektiv të borxhit, theksoj se baza e investorëve, e cila në vitin 2020 me eurobondin shkoi në 85% të eurobondit, është blerë nga menaxherë investimesh nga 75%, që ishte në vitin 2018, dhe përbërja e investorëve është e tillë: 32% nga SHBA-ja, 28% nga Mbretëria e Bashkuar, 10% nga Gjermania; pra 70% nga tri shtete shumë të rëndësishme. Ky është besimi që u jepet financave publike dhe jemi të bindur se është një besim që, edhe me daljen në tregun ndërkombëtar të këtij muaji, do të jetë edhe më i mirë se ai i vitit 2020.

Së fundi, është edhe vlerësimi pozitiv nga kompanitë ndërkombëtare "Moody's" dhe "Standard & Poor's", që ka qenë një vlerësim i qëndrueshëm për financat publike dhe këta janë tregues që bindin investorët, përtej shifrave që ne paraqesim këtu. Theksoj edhe një herë se është shumë e rëndësishme të mbështesim qeverinë, të mbështesim nevojën për investime publike për një buxhet nga më të rëndësishmit në 10 vjetët e fundit për shëndetësinë, për arsimin, për ndihmën ekonomike, për infrastrukturën, por, mbi të gjitha, për rritjen ekonomike që këtë vit parashikohet 8%. Këto janë fakte që nuk mohohen. Faleminderit!

